



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9772/2024
Data: 20.12.2024

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.11.2024 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **KimeteKuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2025.
3. Raporti i auditimit nga divizioni i auditimit të brendshëm -MFPT.
4. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.
5. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Propozim vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në bazë të ligjit për tatim në pronë Kuvendi i Komunës i përcakton normat tatimore për kategoritë e pronave përveç pronës publike. Në këtë propozim vendim është i bashkangjitur edhe raporti i pronave bujqësore i cili është kryer gjatë këtij viti për vitin 2025 . Të bashkangjitur keni materialin që i kemi kategorizuar të gjitha kategoritë e pronave dhe normat tatimore . Për pronën bujqësore dhe pyjore kemi propozuar që të zbritet prej 0.15 % në 0.10 % . Përveç propozim vendimit diçka tjetër nuk kisha shtuar, nëse keni ndonjë rekomandim apo propozim mund të parashtoni.

Resul Suma thekson:- ju e keni propozuar normën tatimore 0.10 % e pse në disa pjesë është 0.20 % , 0.15 % . Për këtë seancë raportin për pronat bujqësore dhe pyjore nuk na është bashkangjitur.

Sherif Berisha thekson:- nuk është dashur të jenë kaq të larta tarifat por është dashur me bashkëpunuar me qytetarët për shkak se nuk janë të gjitha pronat me vlerat, por nuk është ari në çdo vend 10 000 € apo 20000 €, kështu që mendojë që është bërë një lëshim që mendoj nuk është dashur të bëhet.

Lindita Ballazhi thekson:-unë e kam përcjell raportin të cilin e keni në shkresë dhe në imell e kam cek se raportin e keni prej mbledhjes së kaluar që atë raport e keni . Sa i përket normave tatimore bëhet fjalë për pronat bujqësore dhe pyjore prej 0.15 % kemi propozuar që të jetë në 0.10 % , ndërsa për kategoritë tjera të pronave nuk kemi bashkangjitur ndonjë raport prej departamentit të tatimit në pronë të Ministrisë së Financave pasi që në këtë vit vetëm për prona bujqësore dhe pyjore është vlerësimi i pronave. U përmendë se çmimet e pronave janë të larta po ne nuk i caktojmë nivelet e vlerave por është përgjegjësi dhe kompetencë e departamentit të tatimit në pronë të Ministrisë së Financave të cilët për çdo vit vijnë në komunën tonë dhe e inspektojnë çdo pronë dhe e vlerësojnë për çdo kategori të pronës.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket normave tatimore ka një tavan që është i përcaktuar nga departamenti i tatimit në pronë të Ministrisë së Financave dhe jemi munduar që sa do pakë me lehtësuar barrën e qytetarëve për pagesat e këtyre tarifave por me një limit të arsyeshëm por jo në të gjitha kategoritë . Është një propozim të cilin ju mund ta arsyetoni dhe mund ta votoni nëse e shihni të arsyeshëm . Ju e dini mirë që ky vit ka kaluar në faljen e tatimit në pronë për qytetarët që është ndikues në buxhet por me gjithë atë për ta lehtësuar këtë barrë qytetarët na kemi pranuar që me votuar për faljen e borxheve , mirëpo nuk mundemi deri në maksimum apo me i hequr krejt këto tatime por përsëri por është ligji që e përcakton çështjen e tarifave.

Kryesuesi thekson:- në mbledhjen e fundit të kuvendit votuam që të hiqet nga rendi i ditës dhe gjatë pauzës u dakorduam për të gjitha kategoritë që të norma tatimore të ulet në 0.10 % .

Resul Suma thekson:- në mbledhjen e kaluar u dakorduam që norma tatimore me qenë 0.10 % për të gjitha kategoritë. Kërkoj që të kemi pesë minuta pauzë që të konsultohemi për këtë çështje.

Sherif Berisha thekson:- gjatë pauzës të cilën e patëm në mbledhjen e kaluar u dakorduam që të jemi të njoftuar para mbledhjes por nuk kemi pasur ndonjë njoftim konkretë dhe nuk i di arsyet dhe kërkoj sqarim se pse nuk kemi pasur takim para seancës.

Kryesuesi thekson:- nëse jeni në dakrodë që të kemi një pauzë prej pesë minutave që të konsultohemi me shefat e grupeve parlamentare. Pas konsultave që patëm me shefat e grupeve parlamentare u dakorduam që njësit rezidenciale të ulen në 0.10 %, njësitë e objekteve të ulen në 0.10 %.

Lindita Ballazhi thekson:- gjatë konsultave që i patëm me shefat e grupeve parlamentare u dakorduam që njësitë bujqësore të parcelave dhe për njësitë bujqësore të objekteve nga 0.15 % të zbriten në 0.10 % , përpos kësaj edhe për kategoritë e tjera të pronave siç janë për njësitë rezidenciale të parcelave dhe njësitë rezidenciale të objekteve nga 0.15 % në 0.10 % , ndërsa për kategoritë tjera të pronave mbetet e njëjta.

Refet Kalisi thekson:- sa është kostoja e uljes së tatimit a keni bërë ndonjë kalkulim.

Lindita Ballazhi thekson:- nuk kemi bërë ndonjë kalkulim për shkak se një herë duhet ta kemi shumën për një kategori të pronës pastaj normalisht që mundë ti bëjmë kalkulimet tona se sa është niveli i çmimit për atë kategori të pronës duke e shumëzuar me sipërfaqen e asaj prone dhe rezultati i asaj shumëzohet në normën e re tatimore.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR ÇAKTIMIN E NORMAT TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2025

3. Raporti i auditimit nga divizioni i auditimit të brendshëm –MFPT.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në mungesë të auditorit të brendshëm në komunën tonë ne kemi kërkuar me marr shërbim nga divizioni i auditimit të brendshëm nga Ministria e financave punës dhe transfereve dhe ato e kanë auditura komunën tonë dhe ky auditim ka rezultuar me katër të gjetura. E gjetura e parë ka të bëjë që komuna të merr masat e duhura në përputhje me kornizën ligjore në fuqi që të funksionalizoj, harmonizojë dhe të përshtatë strukturën organizative dhe rregulloren me funksionet dhe nevojat për kryerjen e detyrave në arritjen e objektivave dhe misionit. E gjetura e dytë ka të bëjë që komuna duhet të sigurojë planifikim dhe menaxhim të mirë të buxhetit me një analizë, vlerësim më adekuat të nevojave në harmoni me kodet ekonomike me qëllim të pasqyrimin të saktë për të gjitha shpenzimet sipas rregullave financiare . E gjetura e tretë është që të bëhet regjistrimi , kompletimi të gjitha lëndëve për shpenzimet e realizuara dhe mbyllja e obligimeve në afatin kohorë në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. Të përgatitet rregullorja e brendshme për menaxhimin e pasurive jo financiare sipas rregullores Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatën buxhetore.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- për të gjeturën e parë janë planifikuar që të ndërmerren këto aktivitete, do të ndërmarrim masat e duhura për të funksionalizuar, harmonizuar dhe të përshtatim strukturën organizative dhe rregulloren. Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit është 2024-2025. Për të gjeturën e dytë është planifikuar që do të shtohet kontrolli gjatë ekzekutimit të pagesave në mënyrë që çdo pagesë të jetë në harmoni me kodet ekonomike përkatëse. Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit është 2024-2025. Për të gjeturën e tretë është planifikuar që do të shtohet kontrolli gjatë ekzekutimit të pagesave brenda afateve ligjore. Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit është 2024-2025. Për të gjeturën e katërt planifikohet të hartohet Rregullorja në fjalë përgjatë vitit 2024. Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit është 2024-2025.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- është informatë për muajin janar - tetor që janë kryer shumë aktivitete në kuadër të kësaj drejtorie por fokus të veçantë i kisha dhënë muajit tetor rozë që janë bërë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e sëmundjes së kancerit të gjirit, hapjen e fushatës e kemi filluar me marrshi nëpër qytet për kancerin e gjirit, kemi pasur ekskursion me gratë e prekura me kancer, shfaqjen teatrale fustani rozë, kemi pasur radiologun që për gjatë muajit tetor që për çdo të mërkure ka ofruar shërbime për të gjitha gratë e komunitetit. Me datë katërmëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë tetor përmes Ministrisë së Shëndetësisë i kemi mundësuar që përmes mamografisë të ekzaminohen njëzetë e katër gra të komunës sonë falas . Përveç materialeve të cilat i kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Resul Suma thekson:- dy infermiere që janë me Islamik Relief kanë me shkuar në pushim të lehonisë , a do të zëvendësohen . Te disa infermier që janë në staf ka ndodhur një rënie e koeficientit prej gjashtë në gjashtë pik tre dhe ju kanë tërhequr të hollat për muajt që e kanë marr pagën me koeficient gjashtë dhe janë duke u zhvilluar seanca gjygjësore sepse siç thonë ata për gabimin e që e ka bërë ish zyrtari i shëndetësisë.

Sherif Berisha thekson:- është ndërruar orari i punës pa pëlqimin e gjithë stafit të punës. Prej orës shtatë në mëngjes deri në ora tetë në mëngjes nuk ka shërbime sepse unë kam qenë personalisht vetë. Është një shqetësim nga qytetarët se duhet të ketë një numër për me i bërë analizat pra për me hyre më kryer shërbime por nuk e japin numër.

Refet Kalisi thekson:- javën e kaluar isha për me i bërë analizat dhe kam menduar që është në ora shtatë por fillojnë nga ora tetë dhe gjatë kohës që kam pritur kanë ardhur pesë apo gjashtë pacientë që besoj që edhe ata nuk e kanë ditur. Kërkoj sqarim nga drejtoresha se pse është ndërruar orari. Nga stafi dëgjova se nuk është miratimi i të gjithëve për me ndërruar orarin e punës.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- sa i përket zëvendësimit të infermierëve jemi në kontakte me “Islamik Reliefin” për këtë çështje dhe presim aprovimin e tyre dhe me vazhduar me procedurat e reduktimit. Sa i përket koeficientit nuk kemi të drejtë me ja ulur dikujt koeficientin apo me ja ngritur por janë çështje që kanë ardhur direkt nga Ministria e Financave që janë të rregullume sipas listës që ata e kanë paraparë. Ndryshimi i orarit ka ardhur si kërkesë e drejtorit të QKMF-së që ai e ka paraparë për shkak se e kemi të drejtën ligjore për shkak se efikasiteti i punës varet edhe nga ndryshimi i orarit dhe është bërë ky ndryshim se shumica e punëtorëve e që prej tyre dikush ka ardhur në ora shtatë e dhjetë, dikush shtatë e njëzet, dikush shtatë e gjys dhe për mos me krijuar konflikte brenda stafit e kemi gjetur një mesatare të orës që realisht është tu ardhur me udhëzim administrativ që të gjitha QKMF-të me u bërë një orar unikë në tërë Kosovën , komuna e Ferizajt e ka filluar para dy muaje dhe na e kemi filluar tash dhe është mbajtur mbledhja e menaxhementit e ka ardhur si kërkesë e atyre dhe kam marr vendim për ndryshimin e orarit.

Nora Xhoni thekson:- si qëndron puna me rëntgenin dhe te stomatologu për shkak se qytetarët kanë pasur vërejtje.

Hyriete Isufi thekson:- numri i të sëmurëve me kancerë në tërë territori e komunës, a keni ndonjë statistikë se a po shkon në rënie apo në rritje në mënyrë që pak a shumë me i ditur.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- sa i përket rëntgenit dhe stomatologut nuk kemi pasur ndonjë ankesë apo vërejtje nga qytetarët, ndërsa sa i përket numrit të rasteve me kacerë jemi të përgatitur një shkresë dhe me dërguar në departamentin e onkologjisë se sa raste me kancer janë nga Hani i Elezit por është një procedurë që zgjatë dy apo deri në tre muaj.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj që të shfuqizohet vendimi nga drejtoresha dhe të kthehet orari ashtu siç ka qenë në QKMF prej orës shtatë.

Malik Berisha thekson:- nuk e di a jen të informuar për një lloj infeksioni që ka ndodhur te fëmijët, është mirë ta kemi një raport për këtë çështje.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- jemi të informuar me këtë rast dhe të premtën kemi marr informata rreth orës dhjetë rastet e para sepse tre apo katër nxënës kanë marr shërbime dhe është dyshuar për helmim në ushqim . E kam njoftuar institutin kombëtarë të shëndetit publik dhe brenda gjysh ore kanë ardhur së bashku me ekipin të cilët i kanë marr masat e nevojshme, e kanë inspektuar furrën të cilën e kanë mbyllur për disa ditë . Raport zyrtarë për këtë çështje nuk kemi marr ende.

Kryesuesi thekson:- a keni informacione se a janë në gjendje të mirë nxënësit të cilët kanë marr shërbime.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- shumica kanë marr shërbime këtu dhe kanë vazhduar tretëmanin për tri, katër ditë , me përjashtmi të tre rasteve që i kemi që edhe sot janë te marrë këtë shërbim, vetëm një rast është që është transferuar për infektivë në Prishtinë por gjendja e tij shëndetësore është e mirë dhe është liruar prej Spitalit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- disa pyetje më herët që i kam parashtruar edhe në kuvendin e kaluar i kam kërkuar por janë bërë gjashtëdhjetë ditë dhe nuk kam pranuar përgjigje. Kam kërkuar raport që një zyrtarë ligjorë në komunë ka marr me përmbarues një shumë të hollave, por një shumë të hollave e ka marr edhe një punëtorë tjetër. Me shkrim kam kërkuar për këtë çështje se a ka pasur ndonjë vendim për pagesë apo si mundet një zyrtarë ligjorë që prej komunës me marr mjete financiare me përmbarues.

Lindita Ballazhi thekson:- për këtë përgjigje do ta shikojmë bazën ligjore dhe do të ju përgjigjemi.

Sherif Berisha thekson:- para se me hyrë në kuvend isha për vizitë te çerdhja e cila është jo funksionale dhe gjatë kohës sa isha unë aty as drejtoresha as stafi nuk ishin prezentë. Nuk po mundem me besuar që çerdhja mbyllet për dy mijë euro vlerë, gjeneratori është por nuk është funksional.

Hisni Luri thekson:- i nderuar unë kam përgjegjësi më shumë se sa ju sa i përket çerdhes dhe nuk është me dëshirën tonë mbyllja e çerdhes, nuk dua me fajësuar askënd por me bërë zgjidhje mirëpo ju e dini që zgjidhjet nuk bëhen aty për aty e më shuma të caktuar siç i dha parafolësi. Kjo përgjegjësi është punë me rrymë dhe kur ka të bëjë me rrymë po e potencojë që në vitin 2021 është bërë hapja e çerdhes dhe nuk është menduar që me pasur kyçje më shumë që ka nevojë çerdhja por kur shihen vizionet të cilat i kanë pasur vetëm për me hapur çerdhen e unë personalisht nuk po du për me hapur sot e nesër përsëri me u mbyllur për shkak se furnizimi për te çerdhja është tejet i vogël e në mungesë të kësaj kemi aparatura që ka nevojë për me dhezur nxehjen, shporet elektrik, nxehjet që përdorën nëpër klasë. Si shkak i kësaj edhe punimeve që janë bërë nëpër rrugë i kanë dëmtuar kabllo e ka mbetur me një furnizim dhe është tejet i hollë. Në mungesë të energjisë elektrike e bëjmë jo funksionalë atë çerdhe se pa nxehje nuk mundemi mi pru fëmijët. Ne kemi bërë kërkesë që tri herë ka dështuar për me vendosur pompa termike dhe nëse vendosen këto pompa termikë kërkojnë më shumë energji elektrike e shuma për me i kryer këto punë nuk është dy mijë euro po kalon shumë në ndoshta pesëmbëdhjetë mijë euro dhe për këto arsye është e mbyllur çerdhja. Unë i kam ftuar të gjitha instancat e kam ftuar edhe KEDS-in të cilët kanë potencuar se nuk është përgjegjësi e jona për shkak se kur janë bërë kyçjet janë bërë pa lejen tonë por me operatorë privatë. Kur është bërë hapja e çerdhes e dinë fort mirë ata të cilët ishin më herët e kanë bërë pa leje dhe krejt këto telashe po më faturohen mu por unë do të bëjë zgjidhje një herë e për gjithmonë.

Kryesuesi thekson:- kërkoj sqarim për te shkolla fillore që po lëshohen nxënësit më herët.

Hisni Luri thekson:- është duke u vendosur ashensori që është donacion nga Bashkimi Evropian dhe vendosja e ashensorit kërkon siguri dhe tash është në fazën përfundimtare dhe për me ju larguar rrezikut kemi filluar me marr masa që së paku me i zvogëluar minutat e orëve në mënyrë që me bërë zgjidhje sa më shpejtë.

Resul Suma thekson:-kur do të fillojnë punimet për ashensorin në komunë.

Natyra Kalisi thekson:- çështja e ashensorit në komunë është në procedurë, kontrata është nënshkruar dhe brenda këtij viti do të implementohet, kam kërkuar nga menaxheri i kontratës dhe nga zyra e prokurimit që me vazhduar projektin dhe ju kam thënë se nuk marr asnjë përgjegjësi nëse punimet nuk kryhen brenda afateve kohore por kam kërkuar që brenda afatit ligjorë të vazhdohen procedurat.

Xhevahir Dernjani thekson:- në shkollat tona punohet, më mirë është që të shkurtohet orari për se sa me ndodhë ndonjë problem. Te shkolla e mesme "Dardania" çatia është rregulluar sepse kemi potencuar edhe më herët dhe gradualisht edhe punimet tjera të cilat kanë mbetur pa u kryer do të përfundohen.

Zaim Bela thekson:- kërkoj nga drejtorja e urbanizmit që të na njofton për rrugën që është tu rregulluar ka Lagjja Curri dhe te kufiri sepse po doket se shumë e kanë zgjatur.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket rrugës njëmbëdhjetë qershori ata janë tu i kryer punimet dhe kontratën e ka edhe për vitin e ardhshëm, është duke e bërë gati për asfalt dhe ka mundësi që në këtë javë me asfaltuar. Te rruga e Curri e ka përfunduar mbushjen me gurë dhe është gati për asfaltim dhe në këtë vit do të asfaltohet vetëm shtresa e parë, ndërsa vitin e ardhshëm shtresa e dytë.

Sherif Berisha thekson:- gropat që janë hapur në fshatin Gornacë, Seçishtë a kanë pëlqim me shkrim prej Komunës.

Sevdi Dernjani thekson:-sa i përket çështjes së gropave është kontrata që kompania është tu i bërë mbulimet e gropave. Merret pëlqim nga komuna për hapjen e gropave për rregullimin e gypave, me kompaninë "Bifurkacioni" nuk kemi kontratë të lidhur për gropat që i shkakton kompani por në të ardhmen do të diskutojmë që rregullimin e kontratës për mbulimin e të gjitha atyre gropave të cilat i shkaktojnë.

Kryesuesi thekson:-komuna duhet të ketë marrëveshje me kompaninë "Bifurkacioni" sepse kompania e hap gropën ndërsa komuna i jep mjetet financiare që mendoj nuk është në rregull dhe duhet marrëveshje me pasur në mënyrë që pagesën me bërë ai që e bënë dëmtimin.

Sherif Berisha thekson:- ne e kemi votuar buxhetin dhe po dëgjoji fjalë se janë hequr projekte dhe kërkoj informacion të dijë se cilat projekte janë hequr.

Lindita Ballazhi thekson:- si ekzekutiv nuk kemi hequr asnjë projekt dhe ato projekte që janë miratuar në kuvend të komunës i kemi dërguar në departamentin e buxhetit në Ministri të Financave, mirëpo ato ka mundësi që gjatë shqyrtimit të buxhetit të dorëzuar ndonjë projekt ta heqin tërësisht prej listës së projekteve kapitale dhe ato mjete të dalin në rezervë e që për vitin e ardhsh nëse ka dal ndonjë projekt në rezervë ato mjete financiare mund të i bartim nëpër projekte të tjera.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:27.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

